LIGJ
Nr. 91/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN KOMUNITAR "CREATIVE EUROPE 2014"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin komunitar "Creative Europe 2014".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8655, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN "CREATIVE EUROPE": PROGRAMI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR SEKTORIN KULTUROR DHE KRIJUES

Komisioni Evropian, më poshtë i quajtur "Komisioni", në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më poshtë e quajtur "Shqipëria", nga ana tjetër,

duke marrë parasysh se:

1. Marrëveshja Kuadër e nënshkruar më 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë[1] përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Bashkimit Evropian. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se dispozitat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, përcaktohen nga Komisioni dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

2. "Creative Europe": Programi i Bashkimit Evropian për sektorin kulturor dhe krijues u krijua nga rregullorja (BE) nr. 1295/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, e datës 11 dhjetor 2013[2].

Subjektet e vendosura në Shqipëri duhet të kenë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet operative, të cilat duhet të fillojnë përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Si rrjedhojë, kostot që dalin për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon në vitin 2014, mund të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjta kushteve si ato të zbatueshme mbi kostot e shpenzuara nga subjektet që gjenden në shtetet anëtare, me kusht që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

Shqipëria merr pjesë në programin "Creative Europe", i cili është programi i Bashkimit Evropian për sektorin kulturor dhe krijues (më poshtë i quajtur "Programi"), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të

[1] FZ L192, 22.7.2005, f. 2.
[2] FZ L 347, 20.12.2013, f. 221.

Republikës së Shqipërisë, për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe sipas specifikimeve të përmendura në nenet 2-5 të kësaj Marrëveshje.

Neni 2
Kushtet e pjesëmarrjes në Program

Shqipëria merr pjesë në:

a) Nënprogramin kultura;

b) Fushën Ndërsektoriale të Programit, me përjashtimin e Fondit të Garancisë për Sektorin Kulturor dhe Krijues, të përmendur në nenin 14 dhe në përputhje me nenin 8(4) të rregullores (BE) nr. 1295/2013;

c) Nënprogramin MEDIA që nga dita e parë pas konfirmimit me shkrim të shërbimeve përgjegjëse të Komisionit që Shqipëria plotëson kushtet e direktivës 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 mars 2010[3] dhe në përputhje me nenin 8 të rregullores (BE) nr. 1295/2013.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në aktivitetet e Programit realizohet në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregullore (BE) nr. 1295/2013.

Specifikimet dhe kushtet e zbatueshme për pranimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve, dhe për zbatimin e veprimeve nga subjektet e pranueshme nga Shqipëria janë të njëjta me specifikimet dhe kushtet e zbatueshme për subjektet e pranueshme nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Shqipëria krijon strukturat dhe mekanizmat e përshtatshëm në nivel kombëtar dhe merr të gjitha masat e nevojshme për koordinimin dhe organizimin kombëtar të aktiviteteve për të zbatuar programin në përputhje me dispozitat e parashikuara në Rregulloren që krijon këtë Program. Në veçanti, Shqipëria merr përsipër të krijojë Creative Europe Desk në përputhje me nenin 16 të rregullores dhe me udhëzimin e dhënë nga Komisioni.

Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria paguan çdo vit një kontribut financiar në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen dhe zbatimin e Programit do t'i shtohet shumës së përcaktuar për çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për angazhimet për të përmbushur detyrimet financiare që rezultojnë nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe funksionimin e Programit.

Për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit, përdoret një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 3
Kontributi financiar

Rregullat në lidhje me kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën 1.

Neni 4
Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program monitorohet në mënyrë të vazhdueshme mbi bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria i jep Komisionit raportet përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike, të parashikuara nga Bashkimi Evropian në këtë kuadër.

Rregullat në lidhje me kontrollin financiar, kompensimin dhe masa të tjera kundër mashtrimit përcaktohen në shtojcën II.

Neni 5
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje zbatohet për kohëzgjatjen e Programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian vendos që të shtyjë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm në këtë Program, atëherë kjo Marrëveshje shtyhet për të njëjtën kohëzgjatje dhe automatikisht nëse asnjëra nga palët nuk kryen njoftim brenda një muaji që nga hyrja në fuqi e një akti ligjor që shtyn Programin.

Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund të përfundojnë aktivitetet e kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë pas

[3] FZ L95, 15.04.2010, f. 1.

njoftimit me shkrim dymbëdhjetë muaj përpara. Projektet dhe aktivitetet në proces, në kohën e përfundimit të Marrëveshjes, vazhdojnë deri në përfundimin e tyre, sipas kushteve të caktuara në këtë Marrëveshje, ashtu dhe në marrëveshjet kontraktuale të zbatueshme për këto projekte dhe aktivitete, dhe në dispozitat e shtojcave.

Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit me shkrim, me anë të së cilës Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike që janë përmbushur kërkesat e saj të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Marrëveshja do të shtrijë efektet që prej 1 janarit 2014.

Hartuar në.....më.....
Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
(*Emri*)
Ministri i Kulturës i Republikës së Shqipërisë

Hartuar në.....më.....
Për Komisionin, në emër të Bashkimit Evropian
(*Emri*)
Anëtar i Komisionit

SHTOJCA 1

Rregullat për kontributin financiar të Shqipërisë për pjesëmarrjen në programin "Creative Europe": Program i BE-së për sektorin kulturor dhe krijues.

Kontributi vjetor financiar për t'u paguar nga Shqipëria për llogari të BE-së për pjesëmarrjen në Nënprogramin Kultura dhe Fushën Ndërsektoriale të Programit, me përjashtimin e Fondit të Garancisë për Sektorin Kulturor dhe Krijues), të përmendur në nenin 14 dhe në përputhje me nenin 8(4) të rregullores (BE) nr. 1295/2013, është 55 000 euro.

Që nga data 1 janar e vitit kur agjencitë përgjegjëse të Komisionit Evropian do të japin konfirmimin me shkrim se Shqipëria i plotëson kushtet e përcaktuara në direktivën nr. 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 mars 2010, Shqipëria paguan një kontribut prej 95 000 eurosh për të marrë pjesë në Nënprogramin MEDIA. Kontributi i Shqipërisë për vitin e parë të pjesëmarrjes mund të ndryshojë me pëlqimin e përbashkët me shkrim të palëve. Për vitet e tjera në vazhdim, Shqipëria paguan shumën e plotë.

Kostot e udhëtimit dhe të akomodimit për përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për pjesëmarrjen e tyre si vëzhgues në punimet e Komitetit, siç përcaktohet në nenin 23 të Rregullores së BE-së nr. 1295/2013 ose në takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit, rimbursohen nga Komisioni në të njëjtën mënyrë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e vendeve anëtare të BE-së.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare që ofrohet nga Programi për aktivitetet e Creative Europe Desk nuk tejkalon 50 % të buxhetit total për këto aktivitete dhe nuk tejkalon 2/3 e kontributit financiar të vendit të specifikuar në shtojcën 1.

Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, për rregullat financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të BE-së është e zbatueshme dhe për administrimin e kontributit të Shqipërisë.

Kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe në fillim të çdo viti pasues buxhetor, Komisioni i dërgon Shqipërisë një njoftim për të paguar kontributin e saj për kostot e parashikuara në këtë Marrëveshje.

Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare në euro të Komisionit.

Shqipëria paguan kontributin e saj për kostot vjetore jo më vonë se tre muaj pas datës së njoftimit për pagimin e fondeve, kur ky njoftim është dërguar nga Komisioni përpara datës 1 mars, ose jo më vonë se një muaj nëse njoftimi është dërguar pas datës 1 mars. Vonesa në pagesën e kontributit shoqërohet me pagesën nga Shqipëria të interesit për shumën e përcaktuar dhe nga data e përcaktuar. Interesi (kamatëvonesa) llogaritet sipas normave të zbatueshme nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj të rifinancimit, të botuara në serinë C të Gazetës Zyrtare të BE-së, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin mbaron afati i pagesës, plus 3.5 pikë për qind. Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë sa mund të rrezikojë dukshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit, ose është më shumë se 20 ditë pune pas dërgimit të një letre formale kujtese të Komisionit për Shqipërisë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës pezullohet.

SHTOJCA II

I. KONTROLLI FINANCIAR, KOMPENSIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

1. Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian, si dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e granteve të nënshkruara me përfituesit e programit në Shqipëri duhet të parashikojnë auditime financiare dhe auditime të tjera për t'u kryer në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit, për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar nga data e pagesës, me përjashtim të granteve prej një shume të barabartë me ose më të ulët se 60 000 euro për të cilat kjo periudhë do të kufizohet në 3 vjet. Auditimet financiare apo të tjera kryhen në mjediset e kontraktorëve dhe të nënkontraktorëve të tyre, si dhe në mjediset e përfituesve, të kontraktorëve dhe të nënkontraktorëve të tyre nga stafi i Komisionit, ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Stafi i Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni kanë akses në të gjithë informacionin e nevojshëm për auditim, duke përfshirë aksesin edhe në dokumentet elektronike. E drejta për akses duhet të parashikohet shprehimisht në kontratat dhe marrëveshjet e granteve të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta, si dhe Komisioni Evropian.

3. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, Komisioni/OLAF-i (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) është i autorizuar të kryejë kontrolle në terren dhe inspektime në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96, datë 11 nëntor 1996[4].

Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të caktuara nga autoritetet e Shqipërisë, të cilat njoftohet në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ata të mund të japin të gjithë ndihmën e kërkuar.

Nëse autoritetet përkatëse të Shqipërisë dëshirojnë të marrin pjesë në kontrollet në terren dhe në inspektime, atëherë kontrollet në terren dhe inspektime mund të kryhen bashkërisht.

Nëse pjesëmarrësit në Program i rezistojnë kontrollit në terren ose inspektimeve, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në përputhje me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmën e nevojshme për t'u lejuar atyre kryerjen e kontrollit në terren ose të inspektimit.

Komisioni/OLAF-i i raporton sa më shpejt të jetë e mundur autoriteteve përkatëse të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me parregullsitë e zbuluara gjatë kontrollit në terren ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. INFORMIMI DHE KONSULTIMI

1. Për zbatimin e duhur të kësaj shtojce, autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë dhe autoritetet e Bashkimit Evropian shkëmbejnë rregullisht informacion dhe me kërkesë të njërës prej palëve, zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë informojnë menjëherë Komisionin për çdo fakt ose dyshim që kanë për ndonjë parregullsi në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve të grantit të përfunduara në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

III. MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe gjoba në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

IV. KOMPENSIMI

Vendimet e marra nga Komisioni brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, të cilat caktojnë një detyrim material mbi personat, jo mbi shtetet, janë të zbatueshme në Shqipëri. Zbatueshmëria rregullohet nga dispozitat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit ajo zbatohet. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitet tjetër, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti i brendshëm i caktuar për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe i bëhet i ditur Komisionit. Kur këto formalitete të kenë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në përputhje me ligjin e brendshëm, duke e paraqitur çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti përgjegjës. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në përputhje me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë dhe një marrëveshje granti brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, janë të zbatueshme sipas të njëjtave kushte.

[4] FZ L 292, 15. 11. 1996, f. 2

V. KOMUNIKIMI I DREJTPËRDREJTË

Komisioni komunikon drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në Programin “Creative Europe”, Programi i Bashkimit Evropian për sektorin kulturor dhe krijues në Shqipëri. Pjesëmarrësit e Programit në Shqipëri mund t’i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin dhe dokumentet që ata janë të detyruar t’i paraqesin në bazë të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje, si dhe në marrëveshjet e granteve të nënshkruara për zbatimin e tyre.